



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primi/Prejato Received/Delivery	19.01.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRPMSALC	213/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A nr. 402/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.402/2020 të datës 08.12.2020, të parashtruar nga grup ankuesish,

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson avokat me adresë banimi, Rr. "Bajram Karsniqi", Nr.7, Komuna e Podujevës, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 19.01.2021, mori këtë;

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.402/2020 e datës 08.12.2020, të parashtruar nga ankuesit

A r s y e t i m

dhe që të gjithë punëtorë të Komunës së Malishevës, përmes përfaqësuesit të tyre ligjor avokat me datë 08.12.2020, përmes postës kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 3010/2020 e regjistruar me numër A.nr.402/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 14.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Malishevës, ndërsa me datë 29.12.2020 me numër protokollit 3330/2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendosje meritore të çështjes, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 402/2020, e datës 08.12.2020, me numër protokollit 3010/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.12.2020; Autorizimin e datës 18.02.2020, për avokatin Akt Emërimin e datës 24.01.2012; Akt Emërimin e datës 11.01.2012; Akt Emërimin e datës 04.01.2012; Akt Emërimi i datës 24.01.2012; Akt Emërimin e datës 03.03.2014; Akt Emërimin e Bashota i datës 24.01.2012; Akt Emërimin e i datës 24.01.2012; Akt Emërimin e Krasniqi i datës 24.01.2012; Akt Emërimin e datës 24.01.2012; Akt Emërimin e i datës 24.01.2012; Pliko R9764669; Përgjigjen në ankesë te datës 29.12.2020; Listën e pagave të datës 01.12.2020, deri 31.12.2020, për grup ankuesish; vendimin e datës 07.12.2020, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për Krasniqi; vendimin e datës 10.12.2020, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 10.12.2020, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 07.12.2020, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 07.12.2020, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 07.12.2020, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për Listën e pagave të datës 01.12.2019, deri 31.12.2019, për grup ankuesish; vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për Paqarizi; vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për vendimin e datës 27.11.2019, për shpërblimin të përvjetorit (jubile), për Vendim i datës 16.09.2020; Vendim i datës 02.12.2020; Pliko R9765552 e datës 26.12.2020; E-mailin nga dhe E-mail nga për

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës, të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa A.nr.402/2020 e datës 08.12.2020, e parashtruar nga ankuesit

dhe

është e pa lejuar, sepse:

Ankuesit në ankesën e dorëzuar me datë 08.12.2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë që t'iu njihet e drejta për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13) për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, pagat përcjellëse në rastin e pensionimit në lartësi të tri pagave mujore, pagesën për shpërblim jubilar si dhe pagesën për ushqim ditor për ditët e pranisë në punë duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, Ligjin Nr.03/L-212 të Punës, si dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në shkresat e lëndës respektivisht Akt Emërimeve, ka gjetur se ankuesit janë të punësuar në Komunën e Malishevës, që te gjithë nëpunës civilë te karrierës pa afat, e të cilët me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohje të të drejtave të pretenduara si në ankesë, por siç deklarojnë, asnjëherë nuk kanë pranuar ndonjë përgjigje lidhur me kërkesën e tyre. Ndërsa me datë 30.06.2020, ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar



Avokatit kanë parashtruar ankesë, me bazë të njëjtë, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Malishevës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Malishevës më datë 16.09.2020 ka nxjerr Vendim me Nr.01/918 me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës së ankuesve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrat e Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht deklarin e ankuesve se me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohjen e të drejtave të pretenduara si në ankesë, Ankesën e datës 30.06.2020 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pranë Komunës së Malishevës, si dhe Vendimin Nr.01/918, të datës 16.09.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesve, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 08.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 402/2020

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit juridik të grupit ankuesish avokatit
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Malishevës ;
- Arkivit të KPMSHC-së